

Lidhur me 2 çështjet, për të cilat kërkoja fjalën, njëra prej të cilave është kjo që ju sapo e thatë tani. Ne e kemi bërë të qartë qëndrimin tonë që në fillim të kësaj legjislature lidhur me procedurat që ky parlament do të duhet të ndërmarrë lidhur me nismat kushtetuese. Nismat kushtetuese u paraqitën nga ju dhe nga ne pothuajse në të njëjtën kohë. Sipas Rregullores së Kuvendit, madje edhe sipas praktikës më të mirë të të gjitha iniciativave parlamentare për ndërhyrje në aktin më të madh ligjor, siç është Kushtetuta, do të duhet që të ndiqnin po të njëjtën rrugë procedurale, paralele dhe të njëkohshme, që do të thotë në një proces, i cili do të duhej të ishte gjithëpërfshirës për çdo iniciativë për ndërhyrje në Kushtetutë. Këtë e kemi kërkuar që në fillim, madje me ngulm në shumë sesione të Këshillit të Legjislacionit, në mbledhjet e përbashkëta me Komisionin e Ligjeve, dhe kemi parë refuzimin tuaj, refuzimin e maxhorancës për t'i shqyrtuar së paku në mënyrë të përbashkët këto iniciativa kushtetuese.

Për këtë arsye, i gjithë procesi i zhvilluar deri tani është i njëanshëm që nga dita e parë. Po kështu, ka qenë i njëanshëm edhe momenti i përfundimit të veprimtarisë së Këshillit të Legjislacionit për iniciativën tuaj. Po kështu, e njëanshëm është edhe futja e tyre në draftkalendar. Kjo ishte arsyeja pse në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve ne mbajtëm këtë qëndrim. Ne mund të kemi qëndrime të ndryshme mbi thelbin e çdo iniciative parlamentare për ndërhyrje në Kushtetutë, por procesi së paku do të duhet të jetë i tillë. Kushtetuta është akti, në të cilin, së pari, duhet të ndërhyhet sa më pak, por edhe atëherë, kur bihet dakord për të ndërhyrë, ajo të jetë e njëjtë, një ndërhyrje, e cila të mos e shndërrojë këtë akt në një ligj, ku në javën teke ndërhyjnë njëra palë dhe në javën çift ndërhyjnë pala tjetër. Kjo nuk do t'i shërbente as procesit, as legjitimitetit, as harmonizimit të këtyre ndërhyrjeve kushtetuese. Kjo ishte arsyeja pse qëndrimi ynë ishte ai. Ftesa jonë edhe në Konferencën e Kryetarëve, po marr shkas edhe sot, ishte pikërisht kjo gjë: që procedurat për të gjitha iniciativat parlamentare për ndërhyrje në Kushtetutë të jenë të harmonizuara në proces, pa kondicionuar asgjë. Kjo ishte për sa i përket rendit të ditës. Zonja drejtuese e seancës, kam edhe një kërkesë tjetër që nuk ka lidhje me këtë çështje. Në fakt, do të duhej t'i drejtohej Kryetares së Kuvendit, por besoj se ju do t'ia përcillni kërkesën tonë, që është depozituar që në dhjetor 2021, për ecurinë e komisionit hetimor. Ju, personalisht, jeni edhe pjesë e komisionit hetimor "Për inceneratorët".

Dihet sesi ka përfunduar veprimtaria e këtij komisioni. Në datën 20 janar shumica vendosi të mos e miratojë planin e hetimit, duke i dhënë fund veprimtarisë së këtij komisioni, ndërkohë që në komisionin, ku edhe ju jeni pjesë, ka pasur një debat lidhur me përlogaritjen e afateve, zgjatjen e afateve të atij komisioni për shkak se për periudhën nga 20 dhjetor deri më 17 janar, që është periudha e pushimeve të sesionit, nga njëri sesion në tjetrin, pretendimi i palës suaj ka qenë i tillë që ato do të duhej të llogariteshin si ditë pune. Pretendimi ynë, në fakt, i mbështetur në Rregulloren, siç ne e lexojmë Rregulloren, është se ato nuk duhet të llogariten, por duhet të zgjatet afati për atë periudhë të veprimtarisë së komisionit. Për këtë arsye kemi bërë një kërkesë që organi përkatës, Këshilli për Rregulloren, Mandatet, i cili është autoriteti që do të duhet ta interpretojë këtë çështje, të mblidhet sa më shpejt, mundësisht nesër, për t'i dhënë një zgjidhje finale këtij debati dhe për t'i hapur rrugë përfundimisht veprimtarisë dhe ecurisë së komisionit hetimor "Për inceneratorët".